



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA IV

Sesioni Pranveror

Komisioni për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media

Mbledhja nr. 01.

Prishtinë, më 17.03.2011 ora 11:00.

Ndërtesa e Kuvendit, salla N – 10.

PROCESVERBAL

**I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ARSIM, KULTURË, RINI, SPORT,
ADMINISTRATË PUBLIKE, QEVERISJE LOKALE DHE MEDIA**

Në mbledhje morën pjesë : Idriz Vehapi - kryetar, Eqrem Kryeziu, Enis Kervan, Ramë Vataj, Xhevahire Izmaqi, Lirije Kajtazi, Sadri Ferati, Afrim Kasolli, Teuta Haxhiu dhe Jeton Svirca.

Mungoi: Vesimir Savič.

Nga stafi mbështetës i komisionit : Lule Ymeri, Drita Morina, Shaip Goxhuli dhe Mirjeta Heta.

Në mbledhje morën pjesë edhe përfaqësues të OSBE-së, KDI-së, përfaqësuesi i medieve të Kuvendit.

Mbledhjen e kryesoi Idriz Vehapi , kryetar i Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite :

1. Mbledhja konstituive e Komisionit.

Kryesuesi - konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me këtë pikë të rendit të ditës.

Ai tha se kjo mbledhje ka më tepër karakter njohës me anëtarët e Komisionit si dhe me natyrën e punës së Komisionit. Komisioni me fillimin e punës së tij duhet ta hartoi një plan pune i cili duhet të jetë në pajtim me programin e punës së Qeverisë (Strategjinë Legjislative të qeverisë).

Mbarëvajtja e punës së komisionit si dhe koha e mbajtjes së mbledhjeve do të prezantohen në planin e punës që do të hartojmë në bashkëpunim me anëtarët e Komisionit, përmes së cilit do të paraqitet edhe dinamika e punës së komisionit me qëllim të mbulimit të fushëveprimtarisë së tij.

Bazuar nga përbërja e këtij Komisioni shpresojmë të japim kontributin tonë për të mbuluar fushëveprimtarinë e këtij Komisioni, bazuar në këtë shohim se kemi tetë fusha në kuadër të katër Ministrive si dhe fushën e Mediave si fushë e veçantë.

Si Komision do duhej të përqendrohemi në aspektin e amendamentimit të projektligjeve dhe mënyrës së implementimit të ligjeve.

Çështje me rëndësi për Komisionin do të jenë edhe Sfidat nga Raporti i Progresit sipas Planit të Veprimit të Kuvendit për Integrim Evropian.

Si çështje tjetër me rëndësi për këtë Komision është bashkëpunimi me ministritë përkatëse, dhe aspektet në fushëveprimtari të Komisionit.

Anëtarët e komisionit pas prezantimit të tyre shprehen gatishmërinë për të dhënë kontributin e tyre në fushat që mbulon komisioni e veçmas në fushat specifike që i mbulon ky komision.

Anëtarët e komisionit u zotuan se nuk do të mungojë bashkëpunimi edhe përkundër fushave të shumta e të ndryshme që mbulon komisioni.

Mbledhja përfundoi në orën 11:50.

Përgatitur nga :

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

**Kryetari i Komisionit
Idriz Vehapi**
